



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Joint Venture Pelikan Sh.p.k – CMA CGM Agencies Worldwide - CMA CGM Albania Sh.p.k

Në datën 3 tetor 2014, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrevshjes së ortakëve” e nënshkruar midis palëve Pelikan Sh.p.k – CMA CGM Agencies Worldwide, më datë 25 qershor 2014, me objekt krijimin e një ndërmarrje të përbashkët të pavarur (joint venture) CMA CGM Albania Sh.p.k.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Pelikan Sh.p.k** është një shoqëri shqiptare që ushtron aktivitetin e saj dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj : Agjenci Doganore, Agjenci Detare, Agjenci Spedicionere në transportin detar, tokësor , automobilistik , transport mallrash dhe udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit;
- **CMA CGM Agencies Worldwide** është një shoqëri franceze dhe ushtron aktivitetin në: tregun e linjave të kontenierëve për transport detar, shërbime marine, shërbime të transportit detar Ro-Ro, shërbime të terminalit të kontenierëve dhe shërbime logjistike , etj;
- **CMA CGM Albania Sh.p.k Joint Venture**, e cila është krijuar në bazë të Marrëveshjes së Ortakëve do të ketë si objekt të aktivitetit të saj: prokurimin e shërbimeve të agjencisë në fushën tregtare dhe atë të transportit detar; kryerjen e veprimeve multimodale si transport në tokë dhe spedicionin e mallrave, prokurimin e shërbimeve të tjera mbështetëse në lidhje me transportin me anë të të gjitha mjeteve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 3) dhe 12, pika 1) dhe 2, të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax : 0355 4 2234 497, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, nr 4, kati IV, Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al